

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

**PROGRAMI**  
**I KURSIT TË UNIFIKUAR**

**BOJATISJE**

**Kodi: PK-B-7-20**

Miratoi:

MINISTRI

.....

Tiranë, 2022

# PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

## “BOJATISJE”

(PK-B-7-22)

### I. Profili Profesional i Bojatisjes

#### a) *Karakteristikat e Bojaxhiut*

Bojaxhiu është i aftë të kryejë *detyra* profesionale si i punësuar apo i vetpunësuar në firma apo kompani ndertimi ose mbas një përvoje pune krijon një biznes të vogël në punime bojatisje dhe punëson të tjerë në të.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, bojaxhiu duhet që të zotërojë njohuri profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë që lidhen me veprimtarinë profesionale të bojaxhiut

Suksesi i bojaxhiut është i lidhur ngushtë dhe me *sjellje* (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathhtësia, kujdesi, përqendrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, durueshmëria, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

#### b) *Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale*

Profesioni i bojaxhiut është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për bojatisjen e sipërfaqeve të brendëshme dhe të jashtëme të ndërtesave dhe objekteve të ndryshme, si dhe për përparatitje e shitje bojrash për lyerjen e ndërtesave. Ai mund të punësohet ose vetpunësohet në ndërmarrje publike apo private, por edhe mund të vetëpunësohet duke krijuar një grup pune për kryerjen e punimeve të bojatisjes.

Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e bojaxhiut të kualifikuar. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale të ndertimit, apo trajnimit nëpërmjet punës, një bojaxhi mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si teknik i mesëm. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e inxhinierit të ndertimit.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në grupin e vogël “Bojaxhinj, pastrues të strukturave të ndërtesave dhe zanatçinj të lidhura me to”, me kod 713, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

### II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për “Bojatisje”

Në përfundim të Kursit për “Bojatisje”, kursantët do të jenë të aftë të:

- Përshkruajnë profesionin e bojaxhiut.
- Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë bojatisjes.
- Njohin projektin dhe specifikimet teknike të punës që do të kryejnë.
- Përdorin udhëzues – katalogë të ndryshëm për bojatisje.
- Llogarisin volumet e punës dhe materialet e nevojshme për to.
- Bëjnë organizimin e vogël të punës.
- Përzgjedhin dhe përdorin mjetet, instrumentet, pajisjet dhe materialet e duhura të punës.
- Realizojnë përgatitjen e bojrave sipas katalogut me kërkesën e klientit.

- Përgatisin sipërfaqet për bojatisje.
- Kryejnë teknika të ndryshme patinimi.
- Kryejnë bojatisje të sipërfaqeve të brendshme e të jashtme të objektit.
- Kryejnë bojatisje dekorative të ndryshme.
- Kryejnë veshje të mureve me letër dekorative
- Mirëmbajnë mjetet, materialet, pajisjet dhe instrumentet mbas mbarimit të punës.
- Kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për punën e kryer.
- Kryejnë detyra administrative e tregtare.
- Zbatojnë standardet e profesionit të bojaxhiut.
- Komunikojnë me etikë me eprorët, kolegët dhe klientët.

### III. Kërkesat e pranimit në Kursin për “Bojatisje”

Pjesmarrësit në Kursin për ”Bojatisje” duhet të jenë mbi 16 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

### IV. Kohëzgjatja e Kursit për “Bojatisje”

250 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

### V. Modulet e Kursit për “Bojatisje”

Nr	Titulli i Modullit	Kdi	Kohëzgjatja	Rezultatet e të Nxënit
1	<b>Hyrje në profesionin e bojaxhiut</b>	MK-02-235-22	20 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të bojaxhiut.</li> <li>2. Kursanti përshkruan materialet që përdoren për bojatisje.</li> <li>3. Kursanti përshkruan dokumentacionin, objektet dhe mjetet e punës së bojaxhiut.</li> <li>4. Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.</li> </ol>
2	<b>Punime përgatitore për bojatisje.</b>	MK-02-236-22	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kursanti planifikon dhe organizon punën për bojatisjen.</li> <li>2. Kursanti përgatit sipërfaqet për bojatisje.</li> <li>3. Kursanti përgatit bojrat për bojatisje.</li> <li>4. Kursanti kryen patinime.</li> </ol>
3	<b>Bojatisja e sipërfaqeve të brendshme e të jashtme të ndërtesës.</b>	MK-02-237-20	110 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kursanti bojatis sipërfaqet e brendshme të ndërtesës.</li> <li>2. Kursanti bojatis sipërfaqet e jashtme të ndërtesës.</li> </ol>

<b>4</b>	<b>Bojatisja dekorative.</b>	MK-02-238-22	50 orë Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kursanti kryen bojatisje dekorative në sipërfaqe suvatimi.</li> <li>2. Kursanti kryen bojatisje dekorative në sipërfaqe josuvatimi.</li> <li>3. Kursanti kryen bojatisje dekorative.</li> </ol>
<b>5</b>	<b>Veshja e mureve me letër murale</b>	MK-02-239-22	30 orë Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kursanti parapërgatit veshjen e mureve me letër murale.</li> <li>2. Kursanti vesh muret me letër murale</li> </ol>

## VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet e të Nxënit që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE

## VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për “Bojatisje”

### 1. Moduli “Hyrje në profesionin e bojaxhiut”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E BOJAXHIUT	MK-02-235-22
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të bojaxhiut, me funksionet, detyrat dhe veprimtaritë që kryen, me rregullat e sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit, si dhe me përshkrimin e mjedisit, dokumentacionit, materialeve dhe mjeteve të punës.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	20 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
<b>Niveli i parapëlqyer për praninë</b>	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç	
<b>Rezultatet e të Nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RN 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të bojaxhiut</b> <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të përshkruajë rëndësinë që ka bojatisja në aspektet estetike dhe funksionale të ndërtesave.</li><li>- të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës së bojaxhiut.</li><li>- të përshkruajë objektin, kushtet e punës së bojaxhiut.</li><li>- të përshkruajë mjetet, pajisjet dhe instrumentet që përdor bojaxhiu.</li><li>- të përshkruajë kërkesat profesionale të bojaxhiut</li><li>- të tregojë mundësitë e punësimit të bojaxhiut.</li><li>- të përshkruajë mundësitë e karrierës profesionale të bojaxhiut.</li><li>- të përshkruajë rregullat e komunikimit në mënyrë etike me eprorët, kolegët dhe klientët.</li></ul> <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Pyetje përgjigje me gojë.</li><li>- Pyetje përgjigje me shkrim.</li></ul>	
	<p><b>RN 2 Kursanti përshkruan materialet që përdoren për bojatisje</b> <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të listojë llojet e materialeve për patinim e bojatisje.</li><li>- të shpjegojë funksionet dhe përdorimet e materialeve për bojatisje.</li><li>- të bëjë klasifikimin e bojave për lyerje të ndërtesave dhe objekteve të tjera.</li><li>- të interpretojë etiketat e prodhimit në përdorimin e materialeve.</li><li>- të përshkruajë vetitë e materialeve në raport me përbërjen e</li></ul>	

tyre

- të dallojë standartet e materialeve që përdoren në bojatisje.
- të përshkruajë paketimin dhe magazinimin e materialeve për bojatisje.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

**RN 3 Kursanti përshkruan dokumentacionin, objektet dhe mjetet e punës së bojaxhiut.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të lexojë dhe interpretojë skicat e thjeshta ndërtimore.
- të lexojë shënimet teknike në fletën e projektit.
- të interpretojë detajet të ndryshme të patinimit e bojatisjes.
- të dallojë standartet, simbolet shenjat në vizatimin teknik.
- të dallojë elementet përbërese të objektit.
- të dallojë veglat, pajisjet dhe instrumentet për bojatisje.
- të përshkruajë funksionin e mjeteve të punës.
- të përdorë drejt veglat, pajisjet dhe instrumentet për bojatisje.
- të tregojë rëndësinë dhe kërkesat e mirëmbajtjes së veglave, pajisjeve dhe instrumenteve për bojatisje.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

**RN 4 Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të ndriçojë mjaftueshem vendin e punes.
- të kontrollojë veglat, pajisjet dhe instrumentet perpara përdorimit.
- të kontrollojë skelën dhe të sigurojë kembet e saj ne siguresë.
- të vendosë rrjetën mbojtëse në fasada.
- të veshë kompletin e punës së bojaxhiut.
- të zbatojë manualët përkatëse në përdorimin e pajisjeve e instrumenteve të punes.
- të zbatojë rregullat e sigurisë gjatë punës në lartësi.
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes nga rryma e lektrike.
- të bëjë ajrosjen e vazhdueshme të mjedisit të punes.
- të pastrojë vendin e punës gjatë dhe mbas procesit të punës.
- të kujdeset gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimikate.
- të depozitojë ne vendet e duhura mbeturinat e krijuara nga procesi i punës.
- të tregojë veprimet për dhënien e ndihmës së parë për

personat e dëmtuar.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë dhe në mjediset e punës.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës dhe objekte ndertimi. Atyre duhet t'i jepen detyra të përshkruajnë veçoritë e profesionit të bojaxhiut, me funksionet, detyrat dhe veprimtaritë ku mbështetet puna e tyre. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, instrumentet dhe materialet e mëposhtme:

- Kompjuter, vidio projektor, pajisje kancelarie
  - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
  - Mjedise reale të punës për bojatisje.
  - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës për bojatisje.
  - Katalogë, rregullore, detaje, skica, flete projekti, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

## 2. Moduli “Punime përgatitore për bojatisje”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
<b>Titulli dhe kodi</b>	<b>PUNIME PËRGATITORE PËR BOJATISJE</b>	<b>MK-02-236-22</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul që i aftëson kursantët për të planifikuar dhe organizuar punën, për të llogaritur volumet për materialet, për të realizuar teknika te ndryshme patinimi, për të përgatitur si duhet bojrat sipas kërkeses së klientit si dhe për të përgatitur sipërfaqen për bojatisje.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e bojaxhiut”	
<b>Rezultatet e të Nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<b>RN 1 Kursanti planifikon dhe organizon punën për bojatisjen.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Kursanti duhet të jetë i aftë : <ul style="list-style-type: none"><li>- të analizojë dokumentacionin teknik për bojatisjen.</li><li>- të analizojë veçoritë e objektit ku do të bëhet bojatisja.</li><li>- të kryejë matjet dhe llogaritjet e nevojshme për bojatisjen</li><li>- të përcaktojë drejt radhën e kryerjes së punimeve.</li><li>- të llogarisë paraprakisht sipërfaqet për bojatisje.</li><li>- të planifikojë nevojën për burime njerëzore.</li><li>- të llogarisë volumet e materialeve për bojatisjen.</li><li>- të kontrollojë tregun e materialit lidhur me çmimet dhe cilësinë e tyre.</li><li>- të zbatojë teknikat e marketingut për shërbimet e bojatisjes.</li><li>- të përgatisë ofertë për shërbimet e bojatisjes.</li><li>- të analizojë tregun e materialeve dhe mjeteve të punës.</li><li>- të ndajë detyrat e punës sipas aftësive.</li><li>- të hartojë grafikun e punimeve javore, mujore etj.</li><li>- të koordinojë punën me grupin e punonjësve.</li><li>- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike (koston dhe çmimin) për punimet e kryera.</li><li>- të regjistrojë të dhënat për faturat e lëshuara dhe të marra.</li><li>- të zbatojë legjislacionin tatimor të fushës.</li><li>- të ruajë dhe arkivojë të gjithë dokumentacionin.</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Pyetje përgjigje me gojë.</li><li>- Vëzhgimi me listë kontrolli.</li></ul> <b>RN 2 Kursanti përgatit sipërfaqet për bojatisje.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>- të analizojë objektin që do të bojatiset.</li></ul>	



- të përzgjedhë mjetet dhe materialet e nevojshme.
- të mbulojë sipërfaqet që nuk bojatisen.
- të sistemojë dhe mbulojë mobilimet e brendëshme të mjedisit që do të bojatisen.
- të pastrojë vendin e punës dhe sipërfaqet që do të bojatisen.
- të kontrollojë me instrumente rrafshhtësine dhe vertikalishtet e sipërfaqeve.
- të përgatisë stukon për riparimet.
- të kryejë riparimin e parregullsive sipas kushteve teknike.
- të kryejë stukimet e nevojshme.
- të zmerilojë sipërfaqen e stukuar.
- të pastrojë sipërfaqen e riparuar.
- të lyejë sipërfaqet me astar.
- të shënoje kuotat e duhura për bojatisje.
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

**RN 3 Kursanti përgatit bojrat për bojatisje.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të konsultohet me klientin në lidhje me kërkesat që ka për bojrat.
- të konsultohet me katalogët e bojërave.
- të interpretojë etiketat e bojërave dhe pigmenteve.
- të përzgjedhe pigmentet dhe bojrat sipas llojit të sipërfaqes.
- të zbatojë perzierjen e recepturave me holluesin.
- të realizojë kombinimin e ngjyrave sipas katalogut.
- të llogarisë bojen sipas sipërfaqes në m<sup>2</sup>
- të magazinonjë bojën e përgatitur me shenjën dalluese përkatëse.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së bojërave.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

**RN 4 Kursanti kryen patinime.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të interpretojë llojet e ndryshme të patinimit sipas katalogut.
- të përzgjedhë drejt veglat, pajisjet dhe instrumentet e nevojshme për patinimin.
- të përzgjedhë drejt llojin e stukos së patinimit.
- të zbatojë raportin e perzierjes stuko patinimi-ujë.

- të përgatisë stukon për patinimin.
- të përgatisë sipërfaqet për patinimin.
- të kryejë teknikat e ndryshme patinimi në mure me përbërje materiale të ndryshme.
- të kryejë zmerilimin dhe pastrimin e pjesëve të patinuara;
- të kujdeset për veglat, pajisjet, dhe instrumentet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit .

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise pune ose objekt ndertimi ku kryhen punime bojatisje.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave të ndryshme dhe procedurave të punimeve përgatitore për bojatisje.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Kursantët duhet të angazhohen në demonstrime për përfitimin e shkathtësive praktike për punime të teknikave të ndryshme patinimi, për zbatimin e raportit të perzierjes stuko patinimi-uje, respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të ruajtjes së mjedisit dhe mirembajtjes së veglave dhe pajisjeve.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, instrumentet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise pune të praktikës së bojatisjes.
  - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për kryerje punime përgatitore.
  - Rrjeta të gatshme për riparimin e difekteve.
  - Stuko patinimi të llojeve të ndryshme.
  - Siperfaqe të gatshme të realizuara të teknikave të ndryshme patinimi.
  - Bojra të llojeve të ndryshme, pigmente bojrash, hollues etj.
  - Material për mbulimin e siperfaqeve që nuk lyhen.
  - Skica, detaje teknike, katalogje të llojeve të ndryshme patinimi.
  - Tabela llojesh të ndryshme perberese stuko patinimi , manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

### 3. Moduli “Bojatisja e sipërfaqeve të brendshme e të jashtme të ndërtesës”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	<b>BOJATISJA E SIPERFAQEVE TE BRENDESHME E TE JASHTME TE NDERTESES</b>	<b>MK-02-237-20</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul që i aftëson kursantët për të kryer bojatisje të sipërfaqeve të brendshme e të jashtme të ndërtesës, si dhe të kryejë llogaritje ekonomike për punimet e kryera.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	110 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e bojxhiut”.	
<b>Rezultatet e të Nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RN 1 Kursanti bojatis sipërfaqet e brendshme të ndërtesës.</b>  <b>Kriteret e vlerësimit:</b>            Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– të analizojë drejtë shënimet teknike në fletët e projektit.</li> <li>– të këshillohet me klientin për lyerjen e sipërfaqes së brendshme.</li> <li>– të përcaktojë saktë hapat e punës që do të kryejë.</li> <li>– të pastrojë sipërfaqen dhe vendin e punës nga pluhurat.</li> <li>– të kontrollojë përfundimisht sipërfaqen e patinuar.</li> <li>– të lyejë sipërfaqen me astar të gatshëm.</li> <li>– të bëjë ndarjet e nevojshme me bojë në sipërfaqet e brendshme.</li> <li>– të kryejë bojatisjen e dorës së parë.</li> <li>– të kryejë bojatisjen e dorës së dytë.</li> <li>– të pastrojë veglat dhe vendin e punës.</li> <li>– të zbulojë me kujdes sipërfaqet që nuk bojatisen.</li> <li>– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.</li> <li>– të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punimet e kryera.</li> <li>– të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punimet e kryera.</li> </ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Pyetje përgjigje me gojë.</li> <li>– Vëzhgimi me listë kontrolli.</li> </ul>	
	<p><b>RN 2 Kursanti bojatis sipërfaqet e jashtme të ndërtesës.</b>  <b>Kriteret e vlerësimit:</b>            Kursanti duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– të analizojë drejtë shënimet teknike në fletët e projektit.</li> <li>– të këshillohet me klientin për lyerjen e sipërfaqes së</li> </ul>	

jashtme.

- të përcaktojë saktë hapat e punës që do të kryejë.
- të pastrojë sipërfaqen dhe vendin e punës nga pluhurat.
- të kontrollojë përfundimisht sipërfaqen e patinuar.
- të lyejë sipërfaqen me astar të gatshëm.
- të bejë ndarjet e nevojshme me bojë në sipërfaqet e jashtme
- të kryejë bojatisjen e dorës së parë.
- të kryejë bojatisjen e dorës së dytë.
- të pastrojë veglat dhe vendin e punës.
- të zbulojë me kujdes sipërfaqet që nuk bojatisen.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike.
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punimet e kryera.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise pune dhe objekt ndertimi ku kryhen punime bojatisje.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të punimeve bojatisjes te brendshme e te jashtme te objektit.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës per punime të bojatisjes te brendshme e te jashtme te objektit, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur e më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Makine llogaritese, kompjuter, pajisje kancelarie.
  - Mjediset pune të praktikës së bojatisjes.
  - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për kryerje e punimeve te bojatisjes.
  - Skica, detaje teknike, katalogje te llojeve ndryshme bojatisje, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul
  - Pigmente, bojrat baze te bardha dhe te parapergatitura.
  - Komplet i veshjes punes bojaxhiut.
  - Skela te levizshme, shkallë.
-

#### 4. Moduli “Bojatisja dekorative”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	BOJATISJA DEKORATIVE	MK-02-238-22
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul që kursantët i aftëson për të kryer bojatisje dekorative në sipërfaqe suvatimi e josuvatimi, si dhe bojatisje dekorative.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulin “Hyrje në profesionin e bojaxhiut”.	
<b>Rezultatet e të Nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<b>RN 1 Kursanti kryen bojatisje dekorative në sipërfaqe suvatimi.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>– të analizojë objektin dhe sipërfaqet që do të bojatisen.</li><li>– të këshillohet me klientin për bojatisjen dekorative në sipërfaqe suvatimi.</li><li>– të përcaktojë saktë hapat e punës që do të kryejë.</li><li>– të mbulojë sipërfaqet që nuk do të bojatisen.</li><li>– të kontrollojë me instrumente rrafshtësinë dhe vertikalishtet e sipërfaqeve.</li><li>– të kryejë riparimin e difekteve me stuko dekorative sipas kushteve teknike.</li><li>– të pastrojë vendin e punës dhe sipërfaqet që do bojatisen.</li><li>– të përgatisë shabllonet për dekorim</li><li>– të ndajë sipërfaqen për dekorim nga pjesa tjetër duke bërë vijëzimin në suva.</li><li>– të lyejë me astar sipërfaqen që do bojatiset.</li><li>– të vendosë shabllonin në sipërfaqen e suvatimit.</li><li>– të kryejë bojatisjen e sipërfaqes me ngjyren baze.</li><li>– të kryejë bojatisjen dekorative me shabllon.</li><li>– të pastrojë veglat, instrumentet dhe vendin e punës.</li><li>– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Pyetje përgjigje me gojë.</li><li>– Vëzhgimi me listë kontrolli.</li></ul> <b>RN 2 Kursanti kryen bojatisje dekorative në sipërfaqe josuvatimi.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Kursanti duhet të jetë i aftë : <ul style="list-style-type: none"><li>– të analizojë objektin dhe sipërfaqet që do të bojatisen.</li><li>– të këshillohet me klientin për bojatisjen dekorative në</li></ul>	

sipërfaqe josuvatimi.

- të përcaktojë saktë hapat e punës që do të kryejë.
- të mbulojë sipërfaqet që nuk do të bojatisen.
- të analizojë llojin e materialit të sipërfaqes josuvatimi që do të bojatiset
- të mbulojë sipërfaqet që nuk do të bojatisen
- të përcaktojë saktë llojin e bojës që do të përdorë.
- të përgatisë stukon sipas recepturës.
- të kryejë stukimin e sipërfaqeve që do të bojatisen
- të fërkojë me pajisjen zmeriluese sipërfaqen e stukuar.
- të pastrojë sipërfaqen nga pluhurat.
- të lyejë me astar sipërfaqen e stukuar.
- të kryejë bojatisjen dekorative të sipërfaqes me bojra kuarc me spërkatje
- të kryejë bojatisje në sipërfaqe betoni.
- të kryejë bojatisje në sipërfaqe të ndryshme josuvatimi (traret e çative, shkallet etj.) me llak të ngjyrosur në sipërfaqe druri.
- të kryejë lyerje me antikorroziv (antindryshk) në sipërfaqet e metaleve.
- të kryejë hollimin me tretës të bojës zmalto, antigrafit etj.
- të kryejë lyerje me bojë zmalto, antigrafit në sipërfaqet e metaleve me pajisje (pistolet)
- të kryejë pastrimin e veglave dhe vendin e punës.
- të sistemojë materialet në ambalazhet perkatese.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

**RN 3 Kursanti kryen bojatisje dekorative.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë objektin dhe sipërfaqet që do të zbukurohen me bojatisje dekorative.
- të këshillohet me klientin për bojatisjen dekorative
- të përcaktojë saktë hapat e punës që do të kryejë.
- të analizojë llojin e dekorimit.
- të mbulojë sipërfaqet që nuk do të bojatisen
- të përcaktojë llojin e stukos së patinimit
- të përzgjedhë drejt bojrat e përgatitura sipas kërkesës së klientit.
- të kryejë teknika të ndryshme bojatisje dekorimi me anen e pajisjeve perkatese.
- të patinojë sipërfaqen me stuko dekorative (me damare).
- të lyejë me boje akrilik (me baze dylli) me shkelqim sipërfaqen e patinuar.
- të patinojë sipërfaqen me stuko dekorative veneciane
- të lyejë me bojë akrilik me shkelqim sipërfaqen e patinuar

me stuko veneciane.

- të kryejë pastrimin e veglave, pajisjeve e vendin e punes.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së bojatisjes dekorative.
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punimet e kryera.
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punimet e kryera

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në klase ose ne objekte ndertimi ku kryhen punime bojatisje
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve te bojatisjes ne siperfaqe suvatimi e josuvatimi, te bojatisjes dekorative.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve te bojatisjes ne siperfaqe suvatimi e jo suvatimi, te bojatisjes dekorative, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e kryerjes se punimeve te bojatisjes ne siperfaqe suvatimi e jo suvatimi dhe bojatisjes dekorative.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të klasave për mësimin teorik.
  - Mjedise të reparteve praktike ose objekte ndertimi per kryerjen e bojatisjes ne siperfaqe suvatimi e jo suvatimi dhe bojatisjen dekorative.
  - Kompjuter, vidieo projektor, paisje kancelarie.
  - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, shënime dhe punime bojatisje.
  - Materiale e lloje stuko patinimi e bojrash te ndryshme bojatisje.
  - Hollues dhe pigmente te ndryshem bojrash.
  - Skica detajesh të ndryshme patinimi e bojatisjesh.
  - Komplet i veshjes punes se bojaxhiut.
  - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

## 5. Moduli “Veshja e mureve me letër murale”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	<b>VESHJA E MUREVE ME LETËR MURALE</b>	<b>MK-02-239-22</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul që kursantët i aftëson për të kryer veshjen e mureve të ndërtesave me lloje të ndryshme të letrave murale.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e bojxhiut”.	
<b>Rezultatet e të Nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RN 1 Kursanti parapërgatit veshjen e mureve me letër murale.</b>  <b>Kriteret e vlerësimit:</b>            Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– të analizojë objektin dhe sipërfaqet e mureve që do të vishen me letër murale.</li> <li>– të analizojë projektin e objektit për veshjen me letër murale.</li> <li>– të këshillohet me klientin për veshjen e mureve me letër murale.</li> <li>– të bëjë skicën e bashkimit të letrës murale sipas kërkesës së klientit ose projektit.</li> <li>– të përcaktojë saktë hapat e punës që do të kryejë.</li> <li>– të rregullojë vendin e punës për veshjen e mureve me letër murale.</li> <li>– të përzgjedhë letrën murale dhe materialet e tjera.</li> <li>– të përzgjedhë mjetet e punës dhe instrumentat matëse.</li> <li>– të kryejë matjet dhe kontrollet e nevojshme.</li> <li>– të kryejë llogaritjet për volumet e materialeve (letrës murale) që nevojiten.</li> </ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Pyetje përgjigje me gojë.</li> <li>– Vëzhgimi me listë kontrolli.</li> </ul> <p><b>RN 2 Kursanti vesh muret me letër murale.</b>  <b>Kriteret e vlerësimit:</b>            Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– të përgatisë sipërfaqet e mureve për veshjen me letër murale.</li> <li>– të kryejë matjet dhe shënimet e duhura në mure.</li> <li>– të kryejë matjet dhe shënimet e duhura në letrën murale.</li> <li>– të aplikojë materialin ngjites të letrës murale.</li> <li>– të bëjë ngjitjen e letrës murale sipas skicës dhe kërkesave teknike.</li> </ul>	



- të bëjë prerjen e letrës murale sipas skicës dhe kërkesave teknike.
- të kryejë kontrollin e veshjes së mureve me letër murale dhe rregullimet e nevojshme.
- të përdorë mjetet për punime në lartësi.
- të kryejë sistemimin dhe pastrimin e veglave, pajisjeve dhe vendit të punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veshjeve të mureve me letër murale.
- të këshillojë klientin për kujdesin që duhet të tregojë për muret e veshur me letër murale.
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punimet e kryera.
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punimet e kryera

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në klase ose ne objekte ndertimi ku kryhen punime të veshjes së mureve me letër murale.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve të veshjes së mureve me letër murale.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve te parapërgatitjes dhe të veshjes së mureve me letër murale, fillimisht në mënyrë të mbikqyruar dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e kryerjes se punimeve të veshjes së mureve me letër murale.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të klasave për mësimin teorik.
  - Mjedise të reparteve praktike ose objekte ndertimi per kryerjen e punimeve të veshjes së mureve me letër murale.
  - Kompjuter, video projektor, pajisje kancelarie.
  - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, shënime dhe punime të veshjes së mureve me letër murale.
  - Letra murale të llojeve të ndryshme.
-

- 
- Materiale ngjitëse të letrës murale.
  - Komploti i veshjes punes se bojaxhiut.
  - Skela dhe shkallë për punime në lartësi.
  - Skica detajesh të veshjeve të mureve me letër murale.
  - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-